

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “MATEMATIKË INFORMATIKË”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë BACHELOR në “MATEMATIKË INFORMATIKË”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.40, datë 28.02.2025, Bordi i Akreditimit
Cikli i studimit	Bachelor
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej”, Institucion Publik, i Akredituar,
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit **Bachelor në “Matematikë Informatikë”** është të aftësojë studentët në *fushën e Matematikës dhe Informatikës*. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në:

- ✓ Analizën matematike
- ✓ Algjebrën e lartë
- ✓ Propabilitet dhe statistikë
- ✓ Bazën e të dhënave
- ✓ Programim
- ✓ Multimedia

Formimi profesional bazë që synohet nëpërmjet këtij programi është ajo e *specialistit të matematikës dhe IT-së*. Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi në **zgjidhjen, interpretimin, arsyetimin dhe vlerësimin e problemeve në situata reale** që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin e tregut të punës, në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në cikle më të larta si ato të Masterit Profesional, Masterit Shkencor, Doktoraturës etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

- Lëndë të formimit të përgjithshëm** (Analizë matematike1; Algjebër1, 2; Gjometri analitike;) (Kredite 36)
- Lëndë të formimit karakterizues** (Teori e numrave; Fizikë; Hyrje në Shkencat kompjuterike; Analizë matematike 2; Matematikë diskrete; Algoritme & Strukturë të Dhënash; Programim; Sisteme Operative; Topologji dhe analizë funksionale; Programim OOP&GUI; Bazë të dhënash) (Kredite 91)
- Lëndë integruese** (Analizë numerike; Propabilitet & Statistikë; Ekuacione diferencialë; Lëndë me zgjedhje) (Kredite 24)
- Lëndë me zgjedhje** (Shkrim dhe menaxhim projektesh; Arkitekturë dhe Organizim Kompjuteri; Programim Simbolik; Hyrje në Sisteme Programimi; Rrjete Kompjuterike; Kriptografi; Analizë Reale; Programim Java) (Kredite 48)
- Lëndë të formimit plotësues** (Gjuhë e huaj; Kërkime Operacionale; Ndërtim aplikimesh në ACCESS dhe SQL; Praktikë profesionale) (Kredite 21)
- Përgatitje punim diplome** (Kredite 8)

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 4 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer). Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	4 (katër)	5 (pesë)	6 (gjashtë)	7 (shtatë)	8 (tetë)	9 (nëntë)	10 (dhjetë)
PIKËT	0 - 44 pikë	45-54 pikë	55-64 pikë	65-74 pikë	75 – 84 pikë	85 – 94 pikë	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma e ciklit të parë Bachelor në “*Matematikë Informatikë*” është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë e tregut të punës.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Bachelor në “Matematikë Informatikë”* mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në *Matematikë, Informatikë, Inxhinieri matematike, Teknologji informacioni* apo në një fushë të ngjashme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia Bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, në programe si: Master Profesional në fusha të ndryshme matematikore dhe/ose IT; Master i Shkencave në Matematikë-TIK; etj.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë / mësues të matematikës dhe informatikës në fushat e arsimit dhe të IT-së, të kualifikuar me njohuri të tilla si në Matematikë e Informatikë. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në “*Matematikë Informatikë*” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Arsim. (Mësimdhënie të Matematikës dhe Informatikës)
2. Administratën publike.
3. Kompani si specialist matematike dhe IT.
4. Institucione bankare, telekomunikacion, shëndetësore, etj.
5. Ndërmarje të ndryshme ekonomike.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit Bachelor në “*Matematikë Informatikë*” fitojnë njohuri në fushën e matematikës, shkencave kompjuterike dhe informatikës.

PLANI MËSIMOR
I PROGRAMIT TE STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “MATEMATIKË INFORMATIKË”

Nr.	LËNDËT MËSIMORE	FORMA E VLERËSIMIT	KREDITET (ECTS)
VITI I			
1.	ANALIZË MATEMATIKE 1	Provim	12
2.	ALGJEBËR 1	Provim	12
3.	GJEOMETRI ANALITIKE	Provim	6
4.	TEORI E NUMRAVE	Provim	6
5.	FIZIKË	Provim	11
6.	HYRJE NË SHKENCAT KOMPJUTERIKE	Provim	8
7.	GJUHË E HUAJ	Provim	5
VITI II			
8.	ALGJEBËR 2	Provim	6
9.	ANALIZË MATEMATIKE 2	Provim	12
10.	MATEMATIKË DISKRETE	Provim	6
11.	ALGORITËM & STRUKTURË TË DHËNASH	Provim	6
12.	PROGRAMIM	Provim	12
13.	SISTEME OPERATIVE	Provim	6
14.	ANALIZË NUMERIKE	Provim	6
15.	PROBABILITET & STATISTIKË	Provim	6
VITI III			
16.	TOPOLOGJI & ANALIZË FUNKSIONALE	Provim	9
17.	PROGRAMIM OOP & GUI	Provim	9
18.	BAZË TË DHËNASH	Provim	6
19.	EKUACIONE DIFERENCIALE	Provim	6
20.	LËNDË ME ZGJEDHJE	Provim	6
21.	KËRKIME OPERACIONALE	Provim	6
22.	NDERTIM APLIKIMESH NE ACCESS DHE SQL	Provim	6
23.	PRAKTIKE PROFESIONALE		4
24.	PROVIM I PËRGJITHSHËM PËRFUNDIMTAR/ PUNIM DIPLOME		8